



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ .07.2023

NJOFTIM PËR BASHKËPUNTORË

Në kuadër të programit “Forcimi i kapaciteteve të mësuesve në arsimin parauniversitar për të mbështetur nxënësit në zhvillimin e projekteve kurrikularë, duke përdorur aftësitë digjitale, në praktikat gjithëpërfshirëse, në aftësitë e gjuhëve të huaja, në të mësuarit për tranzicionin e gjelbër si dhe mirëqenien e nxënësve” të mbështetur nga UNICEF, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm.

Bashkëpunëtorët duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë.
- b) Të kenë përvojë paraprake në hartimin e dokumenteve kurrikularë, përgatitjen e materialeve mbështetëse për mësuesit, zhvillimin e trajnimeve, monitorimin e veprimtarive në arsimin parashkollor dhe në arsimin bazë.
- c) Të ketë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional.
- d) Të ketë aftësi bashkëpunuese dhe të punës në grup.
- e) Preferohen përfshirje afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
- f) Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

Kandidatët dorëzojnë CV-në dhe këto dokumente:

- Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë.
- Fotokopje e dokumentit të identitetit.
- Numër llogarie bankare.

Këto dokumente do të dorëzohen pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), brenda datës **27.07.2023, ora 16:30**.

Faleminderit!

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

GERTI JANAQI